



Minist. Org.		Nr. Prot.	
Org. Indeksi	02	Prot. Prot.	05-5040
Org. Umr.		Data:	
Nr. l. faqave		Datum:	03/07/2025
Dokument			
No. pages	- 3 -		
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Ured Generalnog Sekretara / Office of the Secretary General

Prishtinë, 03/07/2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), në zbatim të dispozitave të nenit 31 të Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publik nxjerrë këtë:

Qarkore informative nr. 08/2025
për zbatimin e LIGJIT NR. 08/L-197 PËR ZYRTARËT PUBLIK

Për:

1. Drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë;
2. Drejtorin e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut;
3. Kryeinspektorin e Inspektoratit Qendror Shëndetësor;
4. Drejtorin e Agjencisë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
5. Drejtorin e Departamentit Shëndetësor të Burgjeve;
6. Drejtorin e Institutit Special në Shtime;
7. Të gjithë drejtorët e departamenteve/divizioneve brenda Ministrisë së shëndetësisë;

Qëllimi: Kjo qarkore informative ka për qëllim të informoj të gjithë zyrtarët publik për Detyrimin e përgjegjshmërisë;

OBLIGIMET E ZYRATRËVE PUBLIK;

- I.** Zyrtarja/i publik është e obliguar të menaxhojë me kujdes pasurinë shtetërore gjatë ushtrimit të detyrës dhe të përdorë atë vetëm për qëllimin e përcaktuar me ligj dhe sipas rregullave të brendshme të institucionit.
- II.** Zyrtares/it publik nuk i lejohej të shfrytëzojë pasurinë shtetërore për aktivitet jashtë detyrës zyrtare.
- III.** Zyrtarja/i publik duhet të ushtrojë detyrën e saj/tij me përgjegjshmëri dhe mban përgjegjësi të plotë sipas legjislacionit në fuqi, për çdo veprim apo mosveprim të saj/tij në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi.
- IV.** Zyrtarja/i publik është e detyruar të shfrytëzojë orarin e punës me efikasitet dhe vetëm për kryerjen e detyrave të saj/tij të punës.
- V.** Zyrtarja/i publik gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi duhet të veprojë në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e saj/tij privat ta vë para interesit publik.
- VI.** Zyrtarja/i publik duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, i mundshëm apo në dukje.
- VII.** Zyrtarja/i publik ka për detyrë të informojë menjëherë mbikëqyrësen/in e saj/tij për çdo rast dyshimi për konflikt interesi gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe të zbatojë legjislacionin përkatës në fuqi.

Qarkorja i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Drejtorit të Institutit kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë;
- Drejtorit të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut;
- Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendror Shëndetësor;
- Drejtorit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor;

Dr. Naim Bardiqi

Sekretarë Përgjithshëm



- *Drejtorit të Agjencisë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale;*
- *Drejtorit të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve;*
- *Drejtorit të Institutit Special në Shtime;*
- *Të gjithë drejtorëve të Departamenteve/divizioneve brenda Ministrisë së shëndetësisë;*
- *UNFPA, BB, OBSH, UNICEF, SDC, LUX DEV;*
- *Drejtorët e Departamenteve për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale;*
- *ShSKUK;*
- *Drejtorit të Departamentit Ligjor;*
- *Divizioni për komunikim në Msh;*
- *Arkivit.*